



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 91 Prot.

Tiranë, më 09.02.2017

V E N D I M

Nr. 16, datë 09.02.2017

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.91, datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Mat, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 28.04.2016 e në vazhdim)

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 91, datë 25.07.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Mat prej datës 28.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes*) e në vazhdim,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 91, datë 25.07.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., Prot, datë 22.04.2016".
2. Verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin *Bashkia Mat* prej datës 28.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim,

sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Ilija Kukumi	Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
2. Ilir Sauli	Inspektor, Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
3. Ilir Osmanlliu	Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **23.02.2017** dhe do të përfundojë më datën **10.03.2017**.
5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **27.02.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **07.03.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda **3** ditëve.
6. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmërues i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrrur Bashkia Mat.
7. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 141; Fax: 355 4 2268 142

Nr. 91/1 Prot.

Tiranë, 09.02.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 91, datë 25/07/2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Mat, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 28.04.2016 e në vazhdim).

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Mat**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr. 91, datë 25.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., Prot, datë 22.04.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Verifikimi i akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin e Bashkisë Mat, prej datës 28.04.2016 (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes) e në vazhdim.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

4. Periudha e verifikimit:

Fillon me datën e daljes së Vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 91, datë 25.07.2016 “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., Prot, datë 22.04.2016*”, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe në datën e përfundimit të mbikëqyrjes në subjekt (28.04.2016), për rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

5. Afati i verifikimit:

Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **23.02.2017** dhe do të përfundojë brenda datës **10.03.2017**.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

- 1. Ilia Kukumi** Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
- 2. Ilir Sauli** Inspektor, Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
- 3. Ilir Osmanlliu** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë

8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe mbikëqyrjes do të përgatiten relacionet përkatëse nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë, dhe Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do t'i dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*) dhe vendimi paralajmërues në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative lidhur me emërimet e dala në kundërshtim me ligjin.

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr.91, datë 25.07.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.355., Prot, datë 22.04.2016”, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

“1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin, 4/1/c të ligjit, nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Vendimin, nr. 70, datë 22.02.2016, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur në këtë akt administrativ, pozicioni në shërbimin civil.

2. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil për punonjësit, që rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

3. Pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve të punës të zëna në kundërshtim me ligjin, duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:

Së pari, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve, nga 8 (tetë) ish-Komunat apo ish-Bashkia Burrel (aktualisht Bashkia Mat), të cilët kanë qenë të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për shërbimin civil”, i ndryshuar dhe që në kuptim të nenit 67, pika 3, të këtij ligji, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, i plotësojnë kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, dhe të kryejë emërimet pa konkurrim në atë pozicion.

Së dyti, të verifikojë listën e punonjësve të liruar nga shërbimi civil, pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion, pa konkurrim.

Së treti, pasi të ketë ezauruar dy hapat e parë, të shpallë procedurat e konkurrimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.

4. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2016, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira,

zbatimi i të cilit do të ndiqet nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

5. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktet administrative që kanë dalë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 4 punonjësve, si më poshtë:

- Aktin nr.147, datë 05.04.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin “Specialist veteriner”.
- Aktin nr.212, date 14.12.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicion “Përgjegjës i zyrës së bujqësisë”.
- Aktin nr. 93, datë 13.10.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës i zyrës së shërbimeve”.
- Aktin nr. 46, datë 20.01.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në pozicionin “Specialist arkitekt urbanist”.

6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil, pasi të jetë respektuar rendi i veprimeve të përcaktuara më sipër.

7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimi dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimi për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.

- ✓ *Të bëjë publik në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Mat, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nën ligjore, për të materializuar procedurat e rekrutimit, të tilla si:*
 - *Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.*
 - *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
 - *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
 - *Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*
- 8. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mat, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative që janë kryer, për zbatimin e këtij vendimi.*
- 9. *Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin”.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

- II. Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, lidhur me emërimet të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos u respektuar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga data 28.04.2016 (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil) e në vazhdim. Në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta

që kanë të bëjnë me këtë institut të ligjit, do të administrohen kopje të akteve, si dhe do të procedohet me procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Listëpagesat dhe listëprezencat e institucionit, duke filluar nga momenti e mbikëqyrjes së mëparshme deri tek ato aktuale.
4. Aktet administrative të cilat materializojnë emërimet në kundërshtim me ligjin, (aktet e emërimit/ kontratat e përkohshme të punës).
5. Dosjet personale të nëpunësve të emëruar pas verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

**DREJTORIA ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Arbana BASHA

Enkelejda HEBIBASI

DREJTOR

DREJTOR